

## GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

Nr P. 71/2007

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë nga:

**Gjyqtari i EULEX-it, z.Ferdinando Buatier de Mongeot**, gjyqtar kryesues  
**Gjyqtari i EULEX-it, z. Francesco Florit**, anëtar i trupit gjykues  
**Gjyqtari i Kosovës, z. Vehbi Kashtanjeva**, anëtar i trupit gjykues

të ndihmuar nga Jacqueline Ryan, proces- mbajtëse, në çështjen penale kundër:

1) **Nexhat DACIT**, i biri i Mehmetit dhe Nadires, data e lindjes, 24 korrik 1944 i lindur në Tërnavc, me banim në Prishtinë-Velania 18/IV, i martuar, baba i tre fëmijëve, profesor universitar, anëtar i Kuvendit;

2) **Ahmet ALISHANIT**, djali i Kadriut dhe Fatushes, data e lindjes 11 nëntor 1956 në Ternovc i Madh, me banim në Prishtinë-Ulpiana A 5/4 nr. 15, baba i katër fëmijëve, shef i kabinetit të Presidentit të partisë politike LDD;

të akuzuar për veprat penale në vijim:

#### **Nexhat DACI:**

##### **Pika 1.**

*Shpërdorim në kundërshtim me nenin 219 paragrafët (1), (2) të Ligjit penal të Kosovës, veprë e dënueshme me burgim prej një deri në dhjetë vjet, ligj ky në fuqi sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 (ekuivalent me veprën penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës, në kundërshtim me nenin 340, paragrafët (1), (2), (3) të LPK-së, veprë e dënueshme me burgim prej një deri në dhjetë vjet)*

#### **Nexhat DACI dhe Ahmet ALISHANI:**

##### **Pika 2.**

*Shpërdorim në kundërshtim me nenin 219 paragrafët (1), (2) të Ligjit penal të Kosovës, veprë e dënueshme me burgim prej një deri në dhjetë vjet, ligj ky në fuqi sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, në lidhje me nenin 22 të Kodit penal të RSFJ-së (ekuivalent me veprën penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, në kundërshtim me nenin 340, paragrafët (1), (2), (3) të LPK-së, veprë e dënueshme me burgim prej një deri në dhjetë vjet)*

**Nexhat DACI:**

**Pika 3.**

*Shpërdorim në kundërshtim me nenin 219 paragrafët (1), (2) të Ligjit penal të Kosovës, vepër e dënueshme me burgim prej një deri në dhjetë vjet, ligj ky në fuqi sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 (ekuivalent me veprën penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, në kundërshtim me nenin 340, paragrafët (1), (2), (3) të LPK-së, vepër e dënueshme me burgim prej një deri në dhjetë vjet)*

**Pika 4.**

*Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, në kundërshtim me nenin 340 të LPK-së, vepër penale kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet;*

**Nexhat DACI dhe Ahmet ALISHANI:**

**Pika 5.**

*Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, në kundërshtim me nenin 340 të LPK-së, vepër penale kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet;*

Pas mbajtjes së seancave gjyqësore publike më 25 tetor, 01 dhe 4 nëntor 2010, në prani të prokurorit publik të Qarkut znj. Fikrije Fejzullahu, të akuzuarve dhe avokatëve të tyre Bajram Tmava (për Nexhat Daci) dhe Flamur Bogaj i caktuar sipas detyrës zyrtare (për Ahmet Alishanin), dhe të përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë për palën e dëmtuar, shpall publikisht si vijon:

**AKTGJYKIM**

**Nexhat DACI**

**SHPALLET FAJTOR**

për veprën penale të përshkruar në pikën 4 të aktakuzës, sepse në shkurt dhe maj të vitit 2005, Nexhat Daci, në atë kohë Kryetari i Kuvendit të Kosovës (dhe për këtë arsye person zyrtar), me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm, ka përvetësuar shumën prej 590 euro nga buxheti i caktuar për Kuvendin e Kosovës dhe ka përdorur ato para, të cilat i janë besuar atij për shkak të pozitës së tij në kuadër të Kuvendit të Kosovës, për të blerë dy palë syze për veten e tij, duke kryer kështu veprën penale të *përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës*, në kundërshtim me nenin 340, paragrafi 1, i LPK-së;

**Nexhat DACI dhe Ahmet ALISHANI**

**SHPALLEN FAJTORE**

për veprën penale të përshkruar në pikë 5 të aktakuzës (më poshtë e ri-kualifikuar veçanërisht në lidhje me pozitën e Ahmet Alishanit). Në veçanti, në tetor 2005 Nexhat Daci, në atë kohë kryetar i Kuvendit të Kosovës (dhe për këtë arsye person zyrtar), me

qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm , ka përvetësuar shumën e 950 euro nga buxheti i caktuar për Kuvendin e Kosovës dhe ka përdorur ato para, të cilat i janë besuar atij për shkak të pozitës së tij në kuadër të Kuvendit të Kosovës, për të paguar për punën dentare që është bërë për të, duke kryer kështu veprën penale të *përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës* , në kundërshtim me nenin 340, paragrafi 1, i KPK-së. Ahmet Alishani i ofroi ndihmë Nexhat Dacit në kryerjen e veprës më lart, duke u vene në kontakt me dentistin, duke udhëzuar atë se si t'i përgatisë faturat dhe se si ta marrë pagesën nga buxheti i Kuvendit për punën e kryer dentare në interes të e Nexhat Daci.

**Nexhat DACI dhe Ahmet ALISHANI**

### **LIROHEN**

nga akuzat tjera të paraqitura ndaj tyre në pikat 1, 2 dhe 3 të aktakuzës;

### **PRANDAJ**

**Nexhat DACI** dënohet me tetë muaj burgim për veprën penale të përshkruar në pikën 4 të aktakuzës dhe deri në një vit burgim për veprën penale të përshkruar në pikën 5 të aktakuzës

Në bazë të nenit 71 paragrafi 1 KPK-së, Nexhat Dacit i shqiptohet dënim unik prej një viti e gjashtë muaj.

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të KPK-së, Nexhat Dacit i ndalohet ushtrimi i funksioneve të administratës publike ose të shërbimeve publike për dy vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim;

**Ahmet ALISHANI** dënohet me gjashtë muaj burgim për veprën penale të përshkruar në pikën 5 të aktakuzës.

Në bazë të nenit 41, paragrafi 1 pika 1, 42, 43 dhe 44 (1), (2), (3) të Kodit Penal të Kosovës dënimi kundër Nexhat Daci dhe Ahmet Alishani bëhet dënim më kusht; dënimi nuk do të ekzekutohet në qoftë se të akuzuarit nuk do të kryejnë një vepër tjetër penale për periudhën dy vjet;

**Nexhat DACI dhe Ahmet ALISHANI**, në mënyrë kumulative dhe së bashku, do të kompensojnë palën e dëmtuar, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë. Të dhënat e ofruara në procedurën penale nuk sigurojnë bazë të besueshme për miratimin e ndonjë dëmshpërblimi qoftë të plotë ose të pjesshëm; gjykata, pra, udhëzon palën e dëmtuar të paraqesë padi civile për të gjithë kërkesëpadinë pronësore juridike në pajtim me nenin 112 (2) të KPPK-së.

Dy të akuzuarit do t' i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) i KPPK-së (me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit) në shumën prej 200,00 Euro.

## ARSYETIM

### 1. Historia procedurale

Më 17 dhjetor të vitit 2007, prokurori publik paraqiti një padi PPS 731-4/07 kundër Nexhat Dacit dhe Ahmet Alishanit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë / Priština, për veprat penale të përshkruara më lart.

Më 12 mars 2008 aktakuza u konfirmua plotësisht, me të vetmin korrigjim që të gjitha faktet janë kryer në Prishtinë.

Më 25 tetor 2010 ka filluar shqyrtimi gjyqësor. Asnjë vërejtje nuk u ngrit përkitazi me përbërjen e trupit gjykues.

Gjatë seancës së njëjtë, padia u lexua nga prokurori publik kurse të akuzuarit nuk e pranuan fajin.

Në bazë të nenit 368 paragraf 1 numri 3 të KPPK-së, palët ranë dakord që deklaratat e mëposhtme të dëshmitarëve të mbledhura gjatë fazës hetimore të konstatohen si të lexuara në procesverbalin e shqyrtimit kryesor:

1. Alajdin Ibrahim, dhënë më 24 maj 2007, në polici
2. Parsim Rizaj, dhënë më 27 mars 2007, në polici
3. Parsim Rizaj, dhënë më 8 nëntor 2007, në polici
4. Genc Grezda, dhënë më 30 maj 2007, në polici
5. Adnan Boshniaku dhënë më 17 maj 2007, në polici
6. Shpresa Gosalci dhënë më 17 maj 2007, në polici
7. Jasimina Maxhari të dhënë në 16 maj 2007, në polici
8. Ahmet Cakaj dhënë më 23 mars 2007, në polici
9. Florije Desku dhënë në 16 maj 2007, në polici

Nuk ishte e nevojshme marrja në pyetje e dëshmitarëve për kompletimin e procedurës së provave.

Në të njëjtën ditë, gjykata ua dha palëve listën e provave materiale në bazë të nenit 367/371 të KPPK-së, si vijon:

Deklaratat e të akuzuarve:

1. Deklarata e Nexhat Dacit, e datës 27 nëntor 2007.
2. Deklarata e Ahmet Alishanit, datë 29 nëntor 2007

Deklaratat e dëshmitarëve:

1. Rizaj Parsim: pronar i kompanisë që ka bërë furnizimin me syze
2. Florije Desku: nëpunëse civile e Kuvendit të Kosovës e punësuar në zyrën për buxhet dhe financa

3. Alajdin Ibrahim: zyrtar prokurimi i Kuvendit
4. Ahmet Cakaj: pronari i klinikës që i kreu punët e dhëmbëve.
5. Genc Greznda: pronari i kompanisë i cili ka bërë furnizimin me gjeneratorë
6. Shpresa Goslaci: përgjegjëse e sektorit teknik të Kuvendit të Kosovës
7. Adnan Boshniaku: shefi i shërbimeve teknike të Kuvendit të Kosovës

Shënime zyrtare:

- Shënim zyrtar i datës 2006/09/20 i nënshkruar Adnan Boshnjaku
- Shënim zyrtar i datës 2006/09/20 i nënshkruar Lulzim Latifi
- Shënim zyrtar datë 2006/09/21 i nënshkruar Burim Latifi

Dokumentet që lidhen me blerjen e syzeve:

1. Fatura e datës 26/01/2005 për një shumë prej 370,00 Euro
2. Formulari i urdhër zotimit për një shumë prej 370,00 Euro, i datës 28/01/2005
3. Formulari i urdhër pagesës për 370,00 Euro i datë 02/2005
4. Fatura e datës 26/05/2005 për një shumën prej 220,00 Euro
5. Formular i urdhër zotimit për një shumë prej 220,00 Euro
6. Formulari i urdhër pagesës për shumën prej 220,00 Euro 05/05, datë

Dokumentet në lidhje me punën e dhëmbëve

1. Fatura e datës 23/09/2005 për një shumë prej 450,00 Euro
2. Formulari i fletë-porosisë për një shumë prej 450,00 Euro i datës 2005/12/10
3. Formulari i pagesës për një shumë prej 450,00 Euro datë 10/2005
4. Fatura e datës 23/09/2005 për një shumë prej 500 Euro
5. Formulari i pagesës për një shumë prej 500 Euro i datës 05/10,

Dokumentet në lidhje me blerjen e gjeneratorëve:

1. Fatura për shumën e 9.487,50 Euro e lëshuar më 7 mars 2003 nga Power Supply Solution (Zgjidhja për furnizim me energji elektrike)
2. Raporti i vlerësimit të ofertës dhe rekomandimi për dhënie të kontratës për blerje konkurruese" i lëshuar më 12 mars 2003 nga komisioni i vlerësimit.
3. "Urdhëri i blerjes" i përmbushur më 12 mars 2003
4. kontratën e nënshkruar më 12 mars 2003 në mes të Kuvendit të Kosovës dhe furnizuesit
5. Faturë për shumën e 13.225,00 Euro lëshuar më 11 dhjetor 2003 nga Power Supply Solution (Zgjidhja për furnizim me energji elektrike)
6. Raporti i vlerësimit të ofertës dhe rekomandimi për dhënie të kontratës për blerje konkurruese" i lëshuar më 11 dhjetor 2003 nga komisioni i vlerësimit
7. Kontrata e nënshkruar më 11 dhjetor 2003 në mes të Kuvendit të Kosovës dhe furnizuesit
8. "Urdhëri për blerje" i përpiluar më 18 dhjetor 2003.
9. "Raporti i vlerësimit të ofertës dhe rekomandimi për dhënie të kontratës për blerje konkurruese" i lëshuar më 29 nëntor 2004 nga komisioni i vlerësimit
10. Kontrata e nënshkruar në mes të Kuvendit të Kosovës dhe furnizuesit më 30 nëntor 2004

11. Fatura për shumën e 9.200.00 Euro lëshuar më 6 dhjetor 2004 nga Power Supply Solution (Zgjidhja për furnizim me energji elektrike)

12. "Urdhëri për blerje", të përpiluar më 16 dhjetor 2004

Më 1 nëntor 2010, gjatë shqyrtimit kryesor dëgjimi i të akuzuarve Nexhat Daci dhe Ahmet Alishani u zhvillua në të cilën seancë i akuzuari Ahmet Alishani mbrojti veten në heshtje.

Më 4 nëntor 2010, gjykata vazhdoi me fjalët përfundimtare të avokatëve mbrojtës dhe deklaratat e fundit të të akuzuarve.

Më 10 nëntor 2010, në prani të palëve (prokurorit dhe avokatëve e mbrojtjes) si dhe të akuzuari, paneli shpalli publikisht aktgjykimin.

## **2. Ligji i aplikueshëm**

Për pikat 1 dhe 2 të aktakuzës, ligj në fuqi është Ligji penal i Kosovës (LPK). Neni 219 i tij, paragrafët (1), (2) të Ligjit Penal të Kosovës, të bëra ligje në fuqi të aplikueshme nga rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 në kohën e kryerjes së veprave penale, për shkak se ajo parashih dënim që nuk është më i rëndë se ai të cilin e parashikon Kodi penal i Kosovës i vitit 2004. Veprat penale të përshkruara në pikat 3,4 dhe 5 të aktakuzës janë, në të kundërtën, të kryera pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal të Kosovës. Në veçanti, vepra penale e pikës 3 daton nga dhjetori 2004 (e jo deri në dhjetor të vitit 2003, siç është përcaktuar gabimisht në pjesën fillestare të aktakuzës). Pra neni 345 të Kodit penal të Kosovës është i zbatueshëm.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë është kompetente për të vendosur për këtë çështje penale, sepse veprat janë kryer në territorin e saj.

Vepra penale e përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare (dhe dispozita e saj homologe e Ligjit penal të Kosovës) bie nën fushëveprimin e nenit 3, paragrafi 3, Lett. P) të Ligjit mbi jurisdiksionin (3 - L053/2008), i cili parashih kompetencën subdiarë të gjyqtarëve të EULEX-it.

Në këtë rast, dy gjyqtarë të EULEX-it janë emëruar nga kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it.

Kërkuar në vecanti në *limine litis*, palët nuk kanë pasur vërejtje në përbërjen e trupit gjykues.

## **3. Çështjet meritorë të rastit**

### **3.1. Përgjegjësia e Nexhat Dacit për pikat 4 dhe 5 të aktakuzës**

Prokuroria ka ofruar prova të mjaftueshme përkitazi me faktin se Nexhat Daci është fajtor për veprat penale të përshkruara në pikat 4 dhe 5 të aktakuzës.

I pandehuri ishte akuzuar për përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në kundërshtim me nenin 340 të kodit penal të Kosovës. Prokurori ka pretenduar se i pandehuri i kishte paguar dy palë syze (për një shumë totale prej 590 euro) dhe punën dentare (19 kurora prej porcelani, për një shumë totale prej 950 euro) me fondet e buxhetit të Kuvendit të Kosovës.

Më poshtë paraqiten në sintezë pohimet e prokurorit:

- Dy herë, në janar 2005 dhe maj 2005, i pandehuri ka kontaktuar me opticienin e syve Parsim Rizajn dhe në të dyja rastet, pas një vizite, ai porositi nga një palë syze (për çmimin 370 Euro dhe 220 Euro);

- Në emër të Kryetarit të Kuvendit, një individ i paidentifikuar i mori syzet kur ato u përgatitën dhe mori faturat nga Parsim Rizaj në mënyrë që të procesohet pagesa.

- Në të njëjtin vit i akuzuari personalisht ra dakord me dentistin Ahmet Cakaj që të bëhet rindërtimi i 19 dhëmbëve, me ngulitje të kurorave prej porcelani. Punë është bërë nga dentisti dhe më pas më 23 shtator 2005, ai lëshoi dy fatura (njëra në shumën 450 kurse tjetra 500 euro) për punët e dhëmbëve të cilat ai i kishte ka kryer në favor të Nexhat Dacit. Të dy faturat janë lëshuar sipas udhëzimeve të cilat Ahmet Alishani ia kishte dhënë Cakajt.

- Pagesa është kryer më pas në llogaritë bankare të Parsim Rizajt dhe Ahmet Cakajt, mbi bazën e urdhër-pagesave të lëshuara nga administrata e Kuvendit.

- Para se të ndodhin blerjet, as Parsim Rizajt dhe as Ahmet Cakajt nuk iu kërkua nga zyrat kompetente të Parlamentit që t'i dërgojnë ofertat e tyre të kontratës;

- Ligjet për prokurimin ashtu siç përcaktohen me Ligjin 2003/17 nuk janë respektuar, në atë se nuk ishte bërë paraprakisht vlerësimi i nevojave dhe se zyra e prokurimit nuk ishte përfshirë.

- Syzet dhe punët e në ndrecjen e dhëmbëve ishin për nevojat e thjeshtë personale të Nexhat Dacit dhe se ato nuk ishin (në qoftë se jo rastësisht) në lidhje me funksionin e tij zyrtar.

Bazuar në faktet e mësipërme, prokurori publik argumentoi se ishin përmbushur kërkesat e nenit 340 LPK-së.

I akuzuari nuk e ka kundërshtuar deklaratat dhe dokumentet e përfshira në dosjen e çështjes, duke rënë dakord që të konstatohen si të lexuara në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të gjitha deklaratat e mëparshme të bëra nga ana e dëshmitarëve në përputhje me art. 368 para 1 n. 3 i Kodit të Procedurës Penale.

Ai, edhe pse, kundërshtoi interpretimin e Prokurorisë, shprehu arsyet e tij për mbrojtjen si më poshtë.

Në përgjigjen e tij me shkrim për të gjitha akuzat gjatë hetimit, Nexhat Daci shpjegoi se: *"Buxheti për Kuvendin e Kosovës ka një gjë të veçantë, e ai është buxheti i kryetarit të Kuvendit. Ky i fundit përmbante një dispozitë për shërbime dhe mallra. Zyra e sekretarit të Kuvendit të Kosovës, nga Buxheti për Presidentin, për shërbime dhe mallra, pagoi një shumë prej 590 euro për një palë syze për lexim të dioptrisë +2,50 dioptry klinikëns për sy "Riza Kompania" në Prishtinë në shkurt 2005. Kjo blerje ka qenë një emergjence*

*përpara një udhëtim jashtë Kosovës, për shkak se syzet personale të blera nga kjo klinikë më parë ishin humbur. Në tetor 2005 zyra e Sekretarit të Kuvendit të Kosovës (si menaxhere për buxhet) bëri një pagesë prej 950 eurosh për shërbimet shëndetësore të dhëmbëve për Kryetarin e Kuvendit, duke pasur parasysh se Kryetari i Kuvendit ka të drejtë t'i mbulohen shpenzimet për shërbimet shëndetësore dhe atë nga buxheti për shërbime dhe mallra. Duhet theksuar se në kohën e punës së Kuvendit të Kosovës, nga dhjetori 2001 deri në mars 2006, nuk ka pasur rregullore të veçantë për shpenzimet nga buxheti për Kryetarin e Kuvendit, si dhe rregullore për shpenzimet e shërbimeve dhe mallrave nga një pjesë e buxhetit për presidentin e Kuvendit ".*

Me rastin e shqyrtimit gjyqësor (1 nëntor 2010), ai deklaroi:

- Se ai nuk kishte autoritet në lidhje me menaxhimin e buxhetit të Kuvendit
- Se ai i kërkoi sekretarit të Kuvendit për të blerë një palë syze për atë sepse ato të parat i kishin humbur
- Se kjo blerje është bërë në interes të Kosovës, para një udhëtimi zyrtar i cili ishte planifikuar të fillojë së shpejti
- Se Kryetari i Kuvendit të Kosovës në atë kohë kishte një buxhet të veçantë (dhe se mallrat dhe shërbimet ishin të përfshira aty)
- Se nuk kishte rregullore të parlamentit në atë kohë që e rregullonte këtë çështje.
- Se lidhur me pagesën e shërbimeve dentare, kjo kishte ndodhur pa dijeninë e tij. Në fakt gruaja e tij kishte shkuar te dentisti për të paguar faturën e familjes dhe dentisti i kishte thënë asaj se shërbimet për kryetarin e parlamentit tashmë ishin paguar nga parlamenti.

Gjatë deklaratave të fundit , në mbrojtjen e Nexhat Dacit u theksuan këto pika:

- Shpenzimet nuk ishin paguar nga ai (i cili nuk kishte autoritet të drejtpërdrejtë mbi buxhetin), por nga sekretariati
- Sekretariati i kishte mjete të ndara nga thesari për nevojat e duhura operationale të Kuvendit.

Trupi gjykues konsideron se sjelljet e Nexhat Dacit, ashtu si u dëshmuar me prova gjatë shqyrtimit kryesor, janë sjellje të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrë në zyre që është në kundërshtim me nenin 340, paragrafi 1, të KPK-së.

Në mënyrë që dënimi të shqiptohet për një vepër të tillë, duhet të dëshmohej me prova rrethanat e mëposhtme:

- Autori i krimit ishte person zyrtar
- Ai kishte të holla, letra me vlerë ose pasuri tjetër të luajtshme që i besohen atij / asaj për shkak të detyrës së vet ose pozitës brenda një organi publik ose një person juridik dhe ai ka përvetësuar mallra të tilla.
- Me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ose për personin tjetër

Tani:

**A. I akuzuari ishte person zyrtar. Në të vërtetë, Nexhat Daci ishte qartë person zyrtar në kohën e fakteve, në bazë të nenit 340 LPK-së. Përkufizimi i personit zyrtar të dhënë me**

nenin 107 të LPK-së është: "një person i zgjedhur ose i emëruar në një organ publik". Ky përkufizim me siguri vlen edhe për anëtarët e Kuvendit e në veçanti për kryetarin e tij (i cili është anëtar i zgjedhur i Parlamentit dhe pas kësaj i emëruar edhe si kryetar i Kuvendit).

**B.** Nexhat Daci ka përvetësuar shumën prej 590 euro (për syze) dhe 950 euro (për punën e dhëmbëve), që i ishin besuar atij për shkak të pozicionit të tij në Parlament.

Sa i përket faktit se Nexhat Daci iu "besuan" paratë e përdorura për blerjen e këtyre objekteve, trupi gjykues ka rënë dakord, para së gjithash, se nocioni i të dorëzuarit në besim i paraparë me nenin 340 të LPK-së është e një natyre të gjerë.

Nuk është e nevojshme, në këtë masë, që mallrat e besuara të jenë në një marrëdhënie formale dhe funksionale me detyrat e personit zyrtar.

Për përcaktimin ligjor është e mjaftueshme që, në sajë të pozitës së tij zyrtare dhe me rastin e shërbimit të tij, i akuzuari ishte - të paktën de facto - në një pozicion të menaxhimit, me fuqinë për të vendosur mbi shfrytëzimin e pronës / mallrave në fjalë.

Në rastin në fjalë, ka fakte të bollshme se roli dhe pozita e Nexhat Dacit i ka mundësuar atij të ketë kontroll dhe mundësi vendimin për shpenzimet e bëra me fondet e buxhetit të Kuvendit të Kosovës (dhe kjo është e vërtetë të paktën në lidhje me shpenzimet e bëra në raste të përshkruar në aktakuzë).

Në të vërtetë:

**B.1.** Është konstatuar (dëshmitarët Parsim Rizaj dhe Ahmet Cakaj) se Nexhat Daci vetë ka shkuar tek opticianti dhe dentisti dhe se ai personalisht ka porositur dy palë syze dhe që të kryhet puna e 19 kurorave prej porcelani për dhëmbët e tij.

Opticiantit dhe dentistit nuk u është përmendur kurrfarë procedure e tenderimit që do të ndërmerrej për kompletimin e blerjes.

As nuk ka dëshmi për ndonjë përfshirje të ndonjë zyre tjetër / apo zyrtarëve tjerë të Parlamentit gjatë porositjes së këtyre mallrave / shërbimeve.

Kjo do të thotë se blerja e syzeve dhe e shërbimeve dentare ishte bërë ndërmjet Dacit dhe palëve tjera, para dhe jashtë çfarëdo procedure tenderuese. Buxheti i Kuvendit dhe i personelit të Kuvendit është përdorur në mënyrë që të paguhet çmimi i kontratave të cilat më parë i kishte bërë Presidenti.

E pas kësaj ishte personeli i kryesisë (Ahmet Alishani në rastin e punëve dentare dhe "shoferi i makinës" në rastin e blerjes së syzeve), ata të cilët i morën faturat, duke i dhënë udhëzime mjekut të syve dhe dentistit se si të merret më vonë me procedurën e pagesës. Përsëri, asnjë gjurmë e përfshirjes së zyrave kompetente teknike të Parlamentit.

**B.2.** Procesi i pagesave i cili u zhvillua më pas (fletë-porositë dhe urdhër-pagesat) u bënë zyrtarisht nga zyra financiare e Parlamentit. Por është e rëndësishme të theksohet se disa faza të procedurës së prokurimit ishin lënë jashtë apo ishin shtrembëruar.

Kjo është bërë e qartë nga deklaratat e dëshmitarëve Florie Desku dhe Alajdin Ibrahimit. E para, zyrtare e buxhetit në Kuvendin e Kosovës gjatë vitit 2005, e nënshkruar si zyrtare certifikuese e urdhër-pagesës për blerjet

Kjo dëshmitare ishte e qartë gjatë deklaratës:

- Se procedura e rregullt e prokurimit nuk është ndjekur;
- Se dikush nga kabineti i Presidentit u kujdes që të shkoj t'i marrë syzet;
- Se ajo konsideronte se nuk ishte mundur që fondet publike të përdoren për t'i blerë syzet personale për Kryetarin të Kuvendit;
- Që përkundër përpjekjeve të saja për t'i ndjekur rregullat "*dikush tjetër e ka fjalën e fundit*".

Kjo dëshmi u përforcua edhe nga deklaratat e Alajdin Ibrahimit, kreut të zyrës së prokurimit të Kuvendit të Kosovës.

Në deklaratën e tij ai sqaroi:

- Që, në kundërshtim me ligjin (i cili parasheh që çdo blerje e më shumë se 100 Euro duhet të kalojë nëpër zyrën e prokurimit), e kjo zyrë nuk ishte e përfshirë në blerjen e dy palë të syzeve dhe të punëve dentare në vitin 2005 ;
- Se zyrtari i prokurimit i cili, megjithatë, e miraton blerjen e syzeve, nuk do të kishte qenë i autorizuar ta miratojë atë blerje në mungesë të një procedure të iniciuar nga zyra e prokurimit.

Përveç kësaj, trupi gjykues vëren se ligji për prokurim kërkon që blerja e mallrave të një vlere më të lartë se 100 euro bëhet kur asaj i paraprin së pari marrja e tri ofertave të ndryshme. Edhe kjo kërkesë ligjore u injorua.

Një pikë tjetër ku procedura e prokurimit u anashkalua konsiston në faktin se punët në ndreçjen e dhëmbëve (me vlerë 950 euro) janë paguar mbi bazën e dy faturave të ndryshme prej 450 dhe 500 euro në vend të një faturë të vetme për një shumë më të madhe. Arsyeja e kësaj nuk ishte asgjë tjetër përveç se për t'iu shmangur nevojës për të përsëritur një tjetër procedurë më të rëndë, më të komplikuar dhe të pavolitshme, e cila është e nevojshme për ato blerjetë cilat tejkalojnë vlerën e 500 Eurove.

Së fundi, dhe më e rëndësishmja, në bazë të ligjit për prokurim, zyrat teknike të sekretariatit teknik duhet ta kenë bërë vlerësimin të nevojave para atyre blerjeve.

Nuk ka dokumente në arkivat të cilat e dëshmojnë me prova përfshirjen e duhur të zyrës së prokurimit dhe kryerjen e vlerësimit të nevojave.

Jo vetëm kjo: analiza e shkresave të lëndës mundëson për të konstatuar se, në mënyrë jo të rregullt, formularët e fletë-porositë që kanë të bëjnë faturat përkatëse i kanë të

vendosura datat mëpastaj. Po t' ishte procedura e rregullt, kjo nuk do të mund të kishte ndodhur, sepse formulari i fletë-porosisë do t' ishte dashur të kompletohet më herët.

**B.3.** Fjalja e fundit e dëshmitares Florie Desku ("*Ne u përpoqëm ta ndjekim procedurën e drejtë, por në fund dikush tjetër e thotë fjalën e fundit*") është kuptimplotë. Kjo sqaron se pavarësisht nga rregullat e sakta mbi prokurimin, në praktikë zyra e Presidentit ia mundësonte vetes pa të drejtë të marrë vendime mbi shpenzimet e buxhetit të Kuvendit, edhe duke e shkelur ligjin.

**B.4.** Trupi gjykues ka rënë dakord me dëshmitaren Desku se natyra e shpenzimeve (syzet dhe dhëmbët prej porcelani), ishte thjesht personale, pa asnjë lidhje (nëse jo aksidentale dhe indirekte) me funksionet zyrtare të kryera nga Nexhat Daci, si kryetar i Kuvendit. Ky përfundim është arritur para së gjithash në një bazë të thjeshtë objektive.

Së dyti, ky konkluzion gjen mbështetje të fortë në faktin (tashmë të thënë) se kriteret ligjore të vlerësimit të nevojave paraprake u anshkaluan nga të akuzuarit.

Kjo është e një rëndësie të madhe, nëse marri parasysh:

- se një procedurë paraqet instrumentin ligjor me të cilin çdo funksion publik shprehet;
- se, në veçanti, procedurat e prokurimit janë mënyrat me anë të së cilave administrata publike i siguron mallrat dhe shërbimet e nevojshme për kryerjen e detyrave të saj;
- Se në procedurën e prokurimit, vlerësimi i nevojave është hapi themelor i paraparë me ligj në mënyrë që të ketë siguri nëse po apo jo një e mirë /apo një shërbim është i nevojshëm për kryerjen e funksionit publik.

Prandaj lënja pas dore e vlerësimit të nevojave është një tregues i fortë se interesi i parlamentit nuk është marrë në konsideratë në kohën e blerjes së shërbimeve dentare dhe të syzeve. Është e denjtë të theksohet se ky konkludim është veçanërisht i vërtetë kur (si në rastin në fjalë) nuk ka ligj ekzistues me të cilin do të konfirmohej se po apo jo disa shpenzime të caktuara kanë të drejtë të jenë të mbuluara me fondet publike.

**B.5.** Fakti ( të cilin e thekson mbrojtja) se ka pasur një linjë buxhetore në buxhetin e Parlamentit, në mesin e atyre që lidhen me zyrën e Presidentit, të quajtura "*mallra dhe shërbime të tjera*", në asnjë mënyrë nuk nënkupton se buxheti mund të përdoret për shpenzime personale të kryetarit të kuvendit (siç po e sygjeron si duket mbrojtja).

Është parimore, me të vërtetë, që një shpenzim ka të drejtë financimi nëpërmjet buxhetit të Kuvendit, nëse shpenzimi i tillë është i natyrës publike dhe hyn në funksion të qëllimeve e Parlamentit. Konkludimi i sugjeruar nga ana e mbrojtjes është plotësisht i papranaueshëm.

Rrethanat e përshkruara më lart nën B.1, B.2, B.3, B.4 dhe B.5 nënkuptojnë që (a) jo vetëm që ato ishin fonde që u përdoren për nevoja personale të Presidentit Daci; (b) jo vetëm që vendimi për blerje u mor nga zyra e tij, por (c) kontrolli e përgjithshëm nga ana

e zyrës së kryesisë së kuvendit ishte aq e thekshme sa që zyrtarët të cilët duhej ta menaxhonin dhe mbikëqyrnin zbatimin korrekt të rregullave të prokurimit ose kanë qenë të përjashtuar nga procedura ose kanë qenë detyruar me anë të ndikimit / osë të urdhëruar të mos u përmbahen procedurave korrekte.

Është e nevojshme të konkludohet, pra, se i akuzuari ka përvetësuar shuma të cilat i janë besuar atij.

C. Në kuadër të zyrës së kryesisë, i akuzuari Daci ishte ai nga i cili doli vendimi për përdorimin e fondeve buxhetore për pagesën e syzeve dhe të punëve në ndreçjen e dhëmbëve.

Ky konkludim është i nevojshëm nëse e marrim parasysh këtë që vijon:

- Natyra e këtyre blerjeve (të syzeve dhe punëve dentare) ishte ngushtë personale për Nexhat Dacin;

- Ai ka ndërmarrë të gjitha kontaktet paraprake me ofruesit e këtyre mallrave / shërbimeve dhe ka bërë kontraktime. Vetëm nga Daci personalisht, kanë mundur, pra, vartësit të kenë ditur për vetë ekzistencën e këtyre shpenzimeve;

- Vetëm Daci ka mundur të japë një kontribut vendimtar për përdorimin e fondeve të Kuvendit për pagesën e këtij lloji personal të mallrave / shërbimeve. Nuk është e konceptueshme që vartësit e Dacit do t'ia linin vetes në mënyrë autonome mundësinë vetvetes për të marrë vendim që nuk u takon për të filluar procedurën e pagesës, pa e pasur urdhërin paraprak nga ai. Ata nuk kanë pasur arsye të mjaftueshme e as autoritet t'i përdorin fondet e buxhetit pa urdhër paraprak nga Daci, sidomos nëse mirret parasysh se me këtë do të bëhej shkelje e rëndë e procedurës së prokurimit.

D. Kriteri i *mens rea*-s (dmth. Qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm pasuror) është dëshmuar gjithashtu.

Në të vërtetë, Daci kishte një rol kyç në vendimin për përdorimin e buxhetit të kuvendit për t'i paguar dhëmbët dhe syzet (shih për këtë elaborimin e bërë më lart nën B). Arsyetimi i tij se nuk ka qenë në dijeni për pagesën që është bërë nga Parlamenti është, për të thënë së paku, naive, siç do të shpjegohet më mirë më poshtë.

Përveç kësaj, u theksua tashmë që mallrat / shërbimet ishin qartë të një natyre personale.

Së fundi, në mënyrë që dhëmbët dhe syzet të paguhen me buxhet, ka qenë e nevojshme të shkelet ligji i prokurimit në disa pika, të anashkalohen zyrat kompetente të Parlamentit.

Kjo është e rëndësishme sa i përket njohurive të të akuzuarit lidhur me paligjshmërinë e blerjes (si dhe dobisë personalisht të tij materiale).

Pretendimet e të akuzuarit se Buxheti i Kuvendit ka mundur të mbulojë një lloj të tillë të shpenzimeve jo vetëm që kanë mbetur krejtësisht të pabazuara, por në kundërshtim ati i ka ardhur edhe fakti (këtë e kanë deklaruar dëshmitarët Desku dhe Ibrahimimi dhe këtë e ka pranuar edhe vetë i akuzuari në deklaratën me shkrim të 27.11.2007) se nuk ka rregullore specifike që lejon një lloj të tillë të shpenzimeve.

E. Arsyetimet më tej të ngritura nga ana e mbrojtjes janë të pabazuara e në disa pjesë edhe qesharake.

Në veçanti:

- Fakti i pretenduar se blerja e syzeve ka ndodhur në një situatë emergjente, dmth në situatën e një udhëtim zyrtar jashtë vendit: ky është i pabazuar në meritat (sepse pagesa, ashtu kështu, u bë vetëm *pasi* kishte përfunduar emergjenca) dhe, së dyti, kjo nuk do të thotë se situata e tillë gjoja emergjente nuk është dashur të zgjidhet duke i vënë në përdorim fondet publike.

- Nuk është e vërtetë, siç pretendohet nga mbrojtja, se Nexhat Daci nuk kishte autoritet mbi buxhetin. Kjo çështja u sqarua më lart nën **B**;

- Nuk është thjesht e besueshme (përsëri duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimeve dhe faktin se askush përpos Dacit vetë nuk ka mundur t'i nformojë të tjerët për ekzistencën e shpenzimeve të tilla personale) se puna dentare dhe syzet janë paguar nga Parlamenti (përmes intervenimit të personelit të zyrës së kryesisë së Kuvendit, dmth përmes të bashkë akuzuarit Ahmet Alishanit) pa e ditur Daci një gjë të tillë.

### 3.2. Përgjegjësia e Ahmet Alishanit për pikën e 5 të aktakuzës

Pozita e këtij të akuzuari në Parlament në kohën e ngjarjeve ishte, zyrtarisht, "këshilltar për siguri" i Kryetarit të Kuvendit.

Ka prova të mjaftueshme për faktin se Alishani e ka ndihmuar Nexhat Dacin në kryerjen e veprës penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës, sipas art. 25 KPK-së.

Kjo është elaboruar më sipër kur është folur për kryerjen e veprës penale nga Nexhat Daci, në të cilën Alishani i dha ndihmë.

Përsa i përket pozitës së veçantë të Alishanit, ajo çfarë duhet dëshmuar është se a ka kryer Alishani ndonjë veprim të përshkruar në nenin 25 KPK-së (dmth. a ka dhënë këshilla ose udhëzime se si të kryhet vepra penale, duke ia vënë në dispozicion kryerësit mjetet për të kryer veprën penale, duke ia hequr pengesat për kryerjen e një vepre penale, apo duke i premtuar që më parë se do t'i fshehë provat e kryerjes së një vepre penale, do ta fshehë identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e një vepre penale, ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e një vepre penale).

Para së gjithash, procedimi i provave tregoi se gama e detyrave që i besohen atij ishte shumë më e gjerë se sa thjesht ajo e një këshilltari të sigurisë.

Është dëshmuar:

- Se ai mori pjesë në procedimin me qëllim të blerjes së gjeneratorëve elektrikë të përshkruar në pikat 1, 2 dhe 3, edhe nëse kjo nuk biente në fushëveprimin e tij të kompetencës;

- Ai i ndihmoi Nexhat Dacit duke e udhëzuar dentistin se si t'i lëshojë faturat;

- Ai i mbledhi ato fatura në mënyrë që të kryhet procedura e pagesës (se edhe ky aktivitet nuk mund të konsiderohet tipik i një këshilltari të sigurisë, por më tepër i një zyrtari të prokurimit);

- Ky ishte personi të cilit i ishte dorëzuar një nga gjeneratorët (përsëri, aktivitet ky tipik i një zyrtari të prokurimit apo ndonjë zyrtari teknik, e jo i një këshilltari të sigurisë).

Sa i përket veçanërisht pagesës së shërbimeve për dhëmbët, prova që është siguruar tregon se:

- Punët dentare u zhvilluan pas një kërkesë të drejtpërdrejtë të Nexhat Dacit;

- Ishte Ahmet Alishani ai i cili u desht të shkojë tek dentisti dhe ta mësojë atë se si të rregullohen faturat. Në veçanti, ai i tha atij se ai duhet t'i lëshojë dy fatura veç e veç për shkak të "*nevojave brendshme*" të Kuvendit;

- Alishani personalisht i nënshkroi ato dy fatura pasi kishte marrë ato (edhe pse kjo qartë dilte jashtë kompetencave të tij personale të këshilltarit të sigurisë).

Kjo më sipër nënkupton:

- Se Alishani ishte informuar nga Daci për punën dentare që ishte bërë.

- Se ai ishte gjithashtu udhëzuar nga ai që fatura e dentistit të paguhet me buxhetin e Kuvendit (siç u arsyetua më mirë sipër).

- Se ai u përpoq t'i bëjë të rregullta pagesat e shërbimit të dhëmbëve duke marrë dy fatura veç e veç edhe përkundër asaj se nuk në krye të buxhetit dhe prokurimit. Duke vepruar kështu, ai i tejkaloar funksionet e veta.

Për ta mbështetur më shumë elementin mendor, duhet theksuar se Alishani i kishte kërkuar dentistit t'i bëjë dy fatura prej një shumë të vogël e cila nuk do e tejkalonte shumën e 500 euro, në vend të një faturë të vetme për shumën totale. Shpjegimi i vetëm i kësaj është që të anashkalohej dispozitat e detyrueshme të prokurimit të cilat për një blerje të tillë e përcaktonin një procedurë më të ndërlikuar që do të mbërthente në vete një rrezik më të madh të dështimit.

Ekzistenca e elementit mendor mbështetet dhe forcohet ende më shumë në faktin, i cili u theksua më lart, që shpenzimet për të cilat ai ra dakord që t'ia vë në barrë buxhetit të Parlamentit ishin në mënyrë të qartë të natyrës personale dhe nuk është e mundur të mendohet se një e gjë e tillë Alishani nuk mund ta ketë injoruar.

Veprimi i Alishanit ka kontribuar në kryerjen e krimit nga Daci, duke i siguruar atij mjete për të kryer veprën penale. Kjo është e mjaftueshme për të përmbushur kriteret e nenit 25 të KPK-së.

Prandaj Alishani është fajtor për ndihmë në kryerjen e përvetësimit në zyrë.

### 3.3. Sa i përket pikave 1, 2 dhe 3 të aktakuzës

Është marrë si i pranuar fakti se gjeneratorët e energjisë elektrike të shënuar në aktakuzë (një gjenerator "Listed Peter 22000", i vlerës së 9.487,50 Euro, një gjenerator "Himoinsa", i vlerës së 13.225 Euro dhe një gjenerator "Wilson FG" me kabinë izolimi i vlerës më tepër se 10,000 Euro) janë blerë nga Kuvendi i Kosovës dhe më pas janë vendosur tek objektet e kryetarit të Kuvendit në Prishtinë - Velania dhe në Brezovicë.

Rrethanat e tilla gjejnë, gjithsesi, mbështetj të plotë në prova që u dhanë gjatë deklaratave të dëshmitarëve dhe dokumentacionin e sekuestruar.

Prokuroria pretendon se vetë fakti se gjeneratorët janë vendosur në mjediset private të Dacit dhe se ata mbetën aty deri gjashtë muaj pas skadimit të pozitës e të akuzuarit si kryetar i Kuvendit të Kosovës tregon veçori të veprës penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrë.

Mbrojtja pretendon se:

- gjeneratorët dhe karburantet e tyre janë siguruar nga stafi teknik i Kuvendit
- kur Daci u zëvendësua, stafi teknik i hoqi hequr gjeneratorët nga objektet e tij dhe i solli ata përsëri në ambientet e Kuvendit
- pra, ishin zyrtar teknikë të Kuvendit at që ishin ngarkuar me gjeneratorë
- kualifikimi ligjor i fakteve duhet të kishte qenë, gjithsesi, jo ai i përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës, por ai i përdorimit të paautorizuar të pasurisë në pajtim me nenin 342 LPK-së (për të cilin statuti i parashkrimit do të kishte skaduar).

I akuzuari Alishani i ka mbështetur argumentet e ngritura nga Daci dhe ka shtuar se blerja gjeneratorëve ishte e nevojshme në mënyrë që t'i ofrohet siguri e mjaftueshme kryetarit të Kuvendit dhe objekteve të tij private. Pa gjeneratorë, nuk do të kishte qenë e mundur që policia t'i ruajë siç duhet objektet e të akuzuarit, veçanërisht në rastet e takimeve zyrtare.

Trupi gjykues ka rënë dakord se prokuroria nuk ishte në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme lidhur me faktin se Daci i ka përvetësuar gjeneratorët, përkundër faktit se procedura e prokurimit për blerjen e gjeneratorëve të njëjtë ishte e parregulltë në disa pjesë.

Shpjegimi dhënë nga i akuzuari lidhur me nevojën për të siguruar, për arsye sigurie (si për kryetarin e Kuvendit e poashtu dhe për të ftuarit zyrtarë eventualo) ndriçim në pjesët e jashtme të shtëpive të tij, i duket trupit gjykues të jetë logjik dhe mjaft i bazuar në rrethana. Një shpjegim i tillë nuk u kundërshtua mjaft nga provat e prokurorisë.

Duhet pohuar, në fakt, se i pandehuri nuk e ka barrën për t'i dëshmuar rrethanat të cilat ai i pretendon në favor të tij, por është e mjaftueshme që ato t'i paraqesë në mënyrë të hollësishme..

Jo vetëm kaq: në këtë rast ka elemente faktike të cilat e mbështesin arsyetimin e

besueshëm të të akuzuarit: në të vërtetë, vlen për t'u theksuar se kapaciteti i gjeneratorëve të blerë ishte i madh, i tepruar për nevojat e zakonshëm të ndriçimit të brendshëm të një banesë të vetme / apo shtëpie. Kjo rrethanë është bërë e qartë jo vetëm nga madhësia e tyre objektive dhe e çmimeve. Kjo është dëshmuar edhe me dëshmitë e zyrtarëve nga shërbimet teknike të Kuvendit, të cilët deklaruan se gjeneratorët, kur ishin shpërndarë në ambientet e parlamentit, ata do të përdroreshin për ndriçimin e një pjese të konsiderueshme të tërë objektit të Parlamentit.

Kjo konfirmon faktin (të cilin e pretendon i akuzuari) se qëllimi i gjeneratorëve ishte të bëjë ndriçimin e zonave të jashtme të shtëpisë së të akuzuarit. Por ndriçimi i tillë i jashtëm ishte i shpjgueshëm vetëm me arsyen ai ishte duke u kryer për arsye të sigurisë, përkatësisht për arsye zyrtare.

Duhet konkluduar se Kuvendi jo vetëm që kishte fuqinë për të vendosur blerjen e gjeneratorëve, por gjithashtu kishte fuqinë për të vendosur shpërndarjen e tyre të përkohshme jashtë mjediseve të Parlamentit.

Është e paqartë nga dokumentet e lëndës se shërbimet teknike të Kuvendit a i morën ata gjeneratorë për t'i kthyer në vend me kërkesën e Dacit apo pa kërkesë të tillë.

Kjo paqartësi shkon në favor të të akuzuarit. Nuk mund të thuhet, me fjalë të tjera, se ka prova që i akuzuari është përpjekur t'i mbajë për vete gjeneratorët, pavarësisht skadimit të mandatit të tij si kryetar i kuvendit.

Dhe fakti se shërbimeve teknike iu deshtën gjashtë muaj për të organizuar kthimin e gjeneratorëve nuk do të thotë vetvetiu se i akuzuari i ka përvetësuar gjeneratorët.

#### **3.4. Kërkesa pronësore juridike dhe mënyra e të dënuarit**

Ministria e Drejtësisë është caktuar me ligj 03/L-048 si përfaqësuese ligjore e autoriteteve publike.

Gjatë shqyrtimit kryesor një zyrtar i autorizuar Ministrisë të tillë u shfaq në gjykatë dhe e shpalli synimin për të paraqitur kërkesë të veçantë pronësore juridike.

Nuk ka vend, pra, për një vendim të tillë mbi kërkesën pronësore juridike në këtë procedim penal.

Sipas nenit 34 të LPK-së, qëllimet e dënimit janë që ta parandalojnë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe për rehabilitimin e tij si dhe për të penguar personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Gjatë llogaritjes së dënimit, trupi gjykues merr parasysh ndër të tjera, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet e kryerjes së veprës penale, intensitetin e rrezikimit ose të

dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajësisë, rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij/apo të saj pas kryerjes së veprës penale.

Në rastin në fjalë, trupi gjykues mori parasysh si rrethanë lehtësuese faktin se përvetësimet që u bënë ishin për një sasi relativisht të vogël të parave.

Është marrë gjithashtu parasysh se të dy të pandehurit nuk kanë dënime të mëparshme dhe ata kanë një moshë relativisht të vjetër.

Për këtë arsye trupi gjykues vendosi ta mbajë ndëshkimin kah pragu më i ulët që parashihet me nenin 340 paragrafi 1 QKK.

Nga ana tjetër trupi gjykues vë në dukje se disa rrethana rënduese evidente janë të pranishme në këtë vepër.

Para së gjithash, ka shkelje të shumta (tre, dy prej të cilave të konsoliduara në një aktakuzë të vetme). Përsëritja e veprave të ngjashme penale është një simptomë e një kapaciteti më të madh kriminal dhe e qëndrimit negativ të të akuzuarve në drejtim të buxhetit të cilat ata kanë mundur ta menaxhojnë.

Së dyti, por më e rëndësishme, trupi gjykues konsideron se nga cilësia personale e Dacit (kryetar i Kuvendit), rrjedh një standard më i lartë i sjelljes dhe një detyrë më e madhe të vëmendjes gjatë ushtrimit të funksionit publik. Andaj një masë më e rreptë duhet të zbatohet. Gjithashtu duhet marrë parasysh se ndikimi dhe pasojat negative të veprimeve të paligjshme mbi publikun e përgjithshëm, janë në një rast të tillë, shumë më keq se mesatarja.

Faktet dëshmojnë se Nexhat Daci ka përjetuar rolin e tij si një privilegj e jo si një shërbim për komunitetin, duke i shfrytëzuar fondet publike në mënyrë që të mbulojë shpenzimet e tij të zakonshme.

Edhe më shqetësuese është se ai kishte urdhëruar / nxitur zyrtarë tjerë publikë të Kuvendit që t'i shtrembërojnë procedurat e prokurimit me qëllim që t'i mundësohet atij përfitim i paligjshëm.

Së treti, fakti që i akuzuari gjatë gjykimit mohoi rrethanat që ishin evidente (rrethanën se ai gjoja nuk e ka ditur se ka pasur pagesa, rrethanën që ai nuk e ka ditur se dikush ia kishte vendosur gjeneratorët në mjediset e tija) është shtesë negative që i bëhet profilit të tij.

Për arsyen e mësipërme, pavarësisht nga shumta relativisht e vogël e përvetësimit, trupi gjykues konsideron se dënimi i duhur në lidhje me krimin e përshkruar në pikën e 5 është një vit dhe tetë muaj burg në lidhje me veprën e përshkruar në pikën e 4 të aktakuzës.

Dënimi unik kur bëhet bashkimi i veprave penale (sipas nenit 71 LPK-së) është prej një viti e gjysmë.

Duke marrë në konsideratë përsëritjen e veprimeve të kryera nga Daci, trupi gjykues konsideron se dënimi plotësues nga neni. 56, paragrafi 2, KPK-së, duhet të shfuqizohet.

I akuzuari Alishani ka asistuar vetëm në kryerjen e një prej dy veprave penale dhe kontributi i tij, edhe pse i rëndësishëm, nuk mund të krahasohet me atë të Dacit. Duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara nga neni 25 dhe 65.2 të KPK-së, dënimi me gjashtë muaj burg konsiderohet si i mjaftueshëm

Dënimi ndaj dy të pandehurve bëhet dënim me kusht në pajtim me art. 43 dhe sipas KPPK-së, duke marrë në konsideratë faktin se asnjëri prej tyre nuk kanë pasur dënime të mëhershme. Kjo e çon trupin gjykues të vie tek përfundimi se qëllimet e dënimit mund të arrihen edhe pa ekzekutimin e dënimit.

Të dy të pandehurit, bashkarisht, dënohen që të bëjnë pagesën e shpenzimeve të procedurës. Shuma është llogaritur në dispozitiv.

Prishtinë, 10/11/2010

Kryetari i trupit gjykues

Buatier Ferdinando de Mongeot



Anëtarët e trupit gjykues:

Francesco Florit

Vehbi Kashtanjeva

Procesverbal mbajtëse:

Jacqueline Ryan

**MJETI JURIDIK:**

Palët kanë të drejtë të apelojnë këtë vendim brenda (15) ditëve prej ditës kur kopja e këtij aktgjykimi të jetë dorëzuar sipas nenit 398 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Ankesa duhet të shpallet brenda tetë ditëve nga data e aktgjykimit.